

## Klubi i Prodhuesve të Kosovës

Rr. Lorenc Antoni, Nr.21,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel.: +377 (0) 45 665 656  
E-Mail: [info@klubiprodhuesve.org](mailto:info@klubiprodhuesve.org)  
Web: klubiprodhuesve.org



KLUBI I PRODHUESVE TË KOSOVËS  
KOSOVO MANUFACTURING CLUB

---

### Për Institucionin/Personin:

Zyra e Rregullatorit për Energji  
Rruga: Dervish Rozhaja nr. 12  
Prishtinë 1000, Kosovë

**Prishtinë, 16. 05. 2019**

Të nderuar,

Së pari më lejoni të ju falënderojmë në emër të anëtarëve të Klubit të Prodhuesve të Kosovës në për përgjigjen e shpejtë në pyetjet e adresuara lidhur me procesin konsultative për përcaktimin e tarifave nxitëse për gjenerimin e energjisë eklektike lidhur përmes paneleve solare.

Bazuar në vlerësimet preliminare dhe në eksperiencën tashme të vërtetuar ne kemi analizuar metodologjinë dhe çmimin e propozuar për përcaktimin e tarifës nxitëse për investime në impiantet fotovoltaike për gjenerimin e energjisë elektrike ne Kosove dhe komentet tona sillen në këto pika ku mendojmë që ZRRE nuk i ka marrë parasysh të gjitha elementet të bazuara në treg:

- Përlllogaritja e WACC
- Investimet Kapitale (Capex)
- Investimet Operative (Opex)

#### 1. Përlllogaritja e Normës Mesatare të Ponderuar së Kostos së Kapitalit

Ne besojmë që Zyra e Rregullatorit të Energjisë duke mos marrë fare parasysh zhvillimin e industrisë merr si shembull krahasues Republikën e Hungarisë me Republikën e Kosovës në përlllogaritjen e WACC-ut, dhe pikërisht këtu i gjithë modeli merr një kahje negative në përcaktimin e normës së kthimit të investimit në investime në burime të ripertëritshme.

Sa për ilustrim do paraqesim një krahasimin të dy ekonomive krahasues në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Hungarisë:

Country Profile

KOSOVO (2017)

HUNGARY (2017)

WORLD VIEW		
Population, total (millions)	1.83	9.79
Population growth (annual %)	0.8	-0.3
Surface area (sq. km) (thousands)	10.9	93.0
Population density (people per sq. km of land area)	168.2	108.1
GNI, Atlas method (current US\$) (billions)	7.15	126.45
GNI per capita, Atlas method (current US\$)	3,900	12,920
GNI, PPP (current international \$) (billions)	20.22	270.62
GNI per capita, PPP (current international \$)	11,050	27,650
PEOPLE		
Income share held by lowest 20%	9.2	7.8
Life expectancy at birth, total (years)	72	76
ENVIRONMENT		
Energy use (kg of oil equivalent per capita)	1,213	2,433
Electric power consumption (kWh per capita)	2,804	3,966
ECONOMY		
GDP (current US\$) (billions)	7.24	139.76
GDP growth (annual %)	4.2	4.1
Public Debt	16.6% of GDP	73.6% of GDP

Përveç krahasueshmërisë ekonomike ne do të paraqesim edhe një tabel ku do të krahasojmë elementet politiko-juridike në mes këtyre dy vendeve, marrë parasysh që gjendja politiko-juridike është një ndër parametrat të cilat kanë efekt jashtëzakonisht të madh në përcaktimin e kostos së kapitalit.

	Hungaria	Kosova
Themelimi i shtetit	895	17 Shkurt, 2008
Anëtarë e OKB-se	PO	JO
Anëtarë e BE-se	PO	JO
Anëtarë e Bankës Botërore	PO	PO
Anëtarë te FMN-se	PO	PO
Konteste kufitare	JO	PO
Konflikte te Hapura	JO	PO

Siç mund të shihet nga tabela 1 dhe Tabela 2, me lartë si në aspektin makroekonomik, makro fiskal, dhe politiko – juridik, këto dy ekonomi/vende nuk kanë asgjë të përbashkët, përveç faktit gjeografikë që janë në kontinentin Evropian, andaj është shokuere dhe e habitshme si si mundet një institucion aq profesional të marr për bazë krahasimore Hungarinë në përcaktimin e normës së ponderuar mesatare të kostos së kapitalit. Presim një shpjegim nga ana juaj lidhur me logjiken e ndërtuar të përzgjedhjes së Hungarisë për këtë aktivitet.

Marre parasysh se Kosova nuk ka ende një vlerësim sovran nga një institucion kredibil ndërkombëtar, dhe vetëm ky element tregon mbi rrezikshmërinë/koston e kapitalit për te investuar ne Kosove, e bene te vështir krijimin e një baze mbi te cilën te përllogaritet risku i investimit/kosto e kapitalit. Mirëpo, ne thellësisht besojmë që të paktën Kosova të krahasohet me regjionin ne te cilin operon dhe jo me vende tërësisht dhe diametralisht te kundërta.

Nëse marrim për baze regjionin dhe bazuar në hulumtimin tonë në dy institucione/publikime tërësisht të pavarura, Domordian database dhe OECD Country Index, ne përllogaritjen e riskut për Kosovën.

Me poshtë është lista e vendeve te Ballkanit me llogaritje te Risku te ekuitetit dhe vendit sipas databazes Demordian:

Country	GDP (in billions)	Moody's rating	Adj. Default Spread	Equity Risk Premium	Country Risk Premium	Corporate Tax Rate
Albania	13.04	B1	5 %	12 %	6 %	15 %
BiH	18.17	B3	7 %	15 %	9 %	10 %
Bulgaria	56.83	Baa2	2 %	9 %	3 %	10 %
Croatia	54.85	Ba2	3 %	10 %	4 %	18 %
Hungary	139.14	Baa3	2 %	9 %	3 %	9 %
Macedonia	50.36	Ba3	4 %	11 %	5 %	10 %
Montenegro	4.77	B1	5 %	12 %	6 %	9 %
Romania	211.80	Baa3	2 %	9 %	3 %	16 %
Serbia	41.43	Ba3	4 %	11 %	5 %	15 %
Germany	3677.44	Aaa	0 %	6 %	0 %	15 %

Ndërsa vlerësimi i riskut të Republikës së Kosovës sipas OECD në krahasim me vendet e regjionit mund ta shini me poshtë, vlerësimi 1 është risk më i ulët ndërsa 7 risku më i lartë.

Country	Classification	
	Previous	Current Prevailing
Albania	6	5
BiH	7	7
Bulgaria	3	3
Croatia	4	4
Hungary	High Income OECD Country not reviewed or classified.	
Macedonia	5	5
Montenegro	7	7
Romania	3	3
Serbia	5	5
Germany	High Income OECD Country not reviewed or classified.	

Siç mund të shihet edhe klasifikimi nga ana e OECD-se se ekspozimit të riksut për huadhënie në Kosovë është shumë më e lartë se vendet e regjionit duke u krahasuar vetëm me Malin e Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina (BiH) ku kanë vlerësim të njëjtë, ndërsa Hungaria e cila është marrë si baze krahasuese në rast të caktimit të WACC për Kosovën, as nuk vlerësohet sepse konsiderohet si vend me të hyra të larta.

Andaj, si rrjedhoja e të dhënave mw lart nga institucione kredibile dhe të pamvaruara kemi ardhur në përfundim se vlera e WACC duhet të rishikohet bazuar në elemente të listuara më poshtë:

Norma pa risk (pa risk)	3%
Kosto e borxhit (real)	5.5 % (mund të ndajm me ZRRë kontrata të fundit të financimit nga bankat vendore)
Kosoto e ekuitetit (para taxes, reale)	14%
Beta	1.19 (Slovenia, bazuar në Raportin e ZRRë-se, Figura 5) Raporti për WACC 2018 -2022.
Hua	40% (bazuar në normën e gearing të bankave vendore)
Ekuitet	60% ((bazuar në normën e gearing të bankave vendore)

Bazuar ne parametrat e cekur me lart WACC para tatimit duhet te jetë **10.6%**

## 2. Investimet Kapitale

ZRRE ne raportin konsultative për mekanizmin e mbështetjes për caqet e BRE-ve, Maj 2019, ka përcaktuar investimet kapitale për 1MW për impiantet fotovoltaike te jenë nga .75 deri .9 milion euro investim bazuar në hulumtime regjionale. Ne besojmë qe kjo vlerë është shumë e ulet në relacion me kosto reale për investim ne këtë fushë. Ne raport ceket qe ka pasur një rënie të ndjeshme te çmimeve për impiante fotovoltaike, mirëpo kjo nuk qëndron. Marrë parasysh kërkesa për investime ne këtë sektor është në rritje e sipër dhe kjo ka krijuar kërkesa jashtëzakonisht te madhe dhe si rrjedhojë çmimet për gjenerator te impianteve elektrike mbeten te larta dhe bazuar ne inovacionin ne teknologjitë e baterive kërkesa për gjenerator fotovoltaik vetëm se do te rritet dhe nuk pritet te ketë zbritje te çmimeve.

Ne tabelën me poshtë mund te shini koston reale te investimeve bazuar ne oferta nga vete prodhuesit dhe historikun e realizimit te projekteve te ngjashme ne vend.

PERSHKRIMI	SHUMA
Studimi i fizibilitetit	€15,000
Zhvillimi dhe Projektimi	€75,000
Vleresimet Mjedisore dhe Leja Mjedisore	€5,000
Pajisjet BRE (panelet diellore FV)	€607,500
Blerja e tokes (1,5 Ha per MW me cmim 1000 euro/ari)	€150,000
Kosto e kycjes ne rrjet	€55,000
Pune ndertimore (objekti dhe rruga)	€40,000
<b>TOTAL CAPEX PER MW</b>	<b>€947,500</b>
<b>TOTAL CAPEX PER KW</b>	<b>€948</b>

## 3. Shpenzimet Operacionale

ZRrE ne raportin konsultativë për mekanizmin e mbështetjes për caqet e BRE-ve, Maj 2019, ka përcaktuar shpenzimet operacionale si 2-3 % te vlerës se investimit. Mirëpo, bazuar ne koston reale te projekteve ne implementim ne vendit tone bazuar ne CAPEX te përlogaritur me lart na del qe koston operacionale janë 10-12% ne proporcion me investimet për 1MW te instaluar, ne jemi te gatshëm ti shpalosim te gjitha këto kosto me kontrata pran rregullatorit.

Me poshtë mund te shihet ndarja e koston operacionale.

<b>PERSHKRIMI</b>	<b>SHUMA</b>
Shpenzimet Operative dhe te Mirembajtjes (O&M)	€75.000
Shpenzimet e jobalancit	€7.500
Shpenzimet per sigurim	€3.000
Shpenzime te paparishikuara	€15.000
<b>TOTAL OPEX</b>	<b>€100.500</b>

Gjithashtu, vlen te theksohet qe impiantet ne Republiken e Kosoves nuk mund te perfitojn kredi te karbonit te cilat do te krijojn te hyra shtes per kete industri ne krahasim me te njëjtit prodhues ne regjion apo me gjere. Andaj, ZRRe duhet te merr për bazë edhe ketëelement ekonomik ne përcaktim e çmimit përimpiante fotovoltaike.

Në konkluzion, dhe bazuar në elementet e lartpërmendura çmimi i propozuar prej 90.4 euro për MW nuk është ekonomikisht i përballueshëm. Andaj, bazuar ne llogaritjet sipas formulës LCOE ne kërkohmë qe çmimi për impiantet fotovoltaike te jete **131**europër MWh të prodhuar.

Mbesim në dispozicionin tuaj dhe shpresojmë qe të reflektohet pozitivisht në kërkesën tonë.

Sinqerisht,

Klubi i Prodhueseve të Kosovës